



Albanian

Gangmasters &
Labour Abuse Authority



TË DREJTAT e Punëtorëve

Mbrojtja e punëtorëve të
cenueshëm dhe të shfrytëzuar

Të drejtat tuaja të punësimit

Të drejtat tuaja si punëtor mbrohen me ligjin e Mbretërisë së Bashkuar. Disa të drejta zbatohen menjëherë sapo ju filloni një punë, ndërsa të tjerat varen nga sa gjatë punoni. Në këtë pjesë përcaktohen gjërat që duhet të prisni nga punëdhënësi juaj. Këto janë të drejtat tuaja ligjore.

Paga minimale kombëtare

Nëse jeni në një marrëdhënie pune të përhershme, nëse keni kontratë me kohë të caktuar apo nëse punoni për një agjenci, minimumi më i ulët që ju duhet të merrni është paga e përshtatshme minimale. Kjo mund të jetë “NMW – National Minimum Wage” [paga minimale kombëtare] ose “NLW – National Living Wage” [paga kombëtare jetike], në varësi të moshës që ju keni.

Nëse ju paguheni për “njësi pune” (p.sh. për numrin e artikujve që përfundoni, paketoni, ngrini, etj), atëherë ju duhet të fitoni gjithsesi një shumë të paktën të barasvlershme me pagën përkatëse minimale. Ka disa përjashtime, duke përfshirë punëtorët e vetëpunësuar dhe vullnetarët.

Për më shumë informata lidhur me normat e pagës minimale dhe të pagës jetike, vizitoni faqen e internetit: **GOV.UK** dhe kërkoni për “**NMW**”-në.

Orët e punës

Ju nuk duhet të punoni më shumë sesa 48 orë në javë, duke përfshirë çdo orë jashtë orarit, përveç nëse keni zgjedhur të punoni në këtë mënyrë.

Ju keni të drejtë të keni të paktën një ditë pushim në javë, ose dy ditë pushim çdo dy javë. Nëse ju punoni më shumë sesa gjashtë orë në ditë, ju duhet të bëni pushim të shkurtër prej të paktën 20 minuta.

Pushimi vjetor

Sipas ligjit, ju keni të drejtë për një numër minimal javësh pushimi të paguar në vit, duke filluar nga dita juaj e parë në punë. Këtu përfshihen punëtorët me kontratë me orar të pjesshëm dhe periudhë të caktuar. Kërkoni për **“pay and work rights”** [paga dhe të drejtat e punës] në faqen e internetit: **GOV.UK** për informatat më të fundit.

Hollësitë e së drejtës suaj për pushim të paguar duhet të paraqiten në kontratën tuaj të punësimit. Për këtë të drejtë, merren për bazë orët normale të punës (në mënyrë përpjesëtimore për punëtorët me orar të pjesshëm), të grumbulluara gjatë kohës që ju punoni për punëdhënësin tuaj dhe pushimi duhet t’ju paguhet me normën tuaj normale të punës. Punëdhënësi juaj ka të drejtë të vendosë se kur e merrni pushimin, por nëse keni probleme me marrjen e lejes për pushim, ju duhet t’i telefononi GLAA-së.

Kur largoheni nga puna, çdo ditë pushimi që paguhet dhe që është grumbulluar, por që ju nuk e keni shfrytëzuar, duhet t'ju paguhet. Nëse punëdhënësi juaj nuk ju lejon të merrni pushime të paguara apo nëse ju ka borxh pagimin e pushimit të pagueshëm, ju mund të kontaktoni “Acas Helpline” [Linja ndihmëse e Acas-it] ose “Citizens Advice” [Zyra e këshillimit të qytetarëve] për udhëzime lidhur me parashtrimin e kërkesave për kthimin e parave. Shihni www.gla.gov.uk/contacts për ndihmë lidhur me gjetjen e numrave të tjerë të kontaktit.

Fletëpagesa e detajuar

Ju duhet të merrni një fletëpagesë ditën kur paguheni, në të cilën tregohet pagesa bruto dhe pagesa që çoni në shtëpi. Fletëpagesa mund të jetë dokument i shtypur apo elektronik dhe në të duhet të shënohet edhe shuma dhe shkaku për çfarëdolloj zbritjeje që mund të jetë bërë nga paga juaj.

Zbritje të tilla si taksat dhe kontributet për “National Insurance” [Sigurimet Kombëtare] mund të ndryshojnë çdo javë dhe duhet të shënohen në çdo fletëpagesë. Ju duhet të pranoni në kohë pagesën për të cilën keni rënë dakord dhe në të duhet të përfshihet çdo ditë pushimi e paguar apo çdo ditë pushimi mjekësor të cilën punëdhënësi duhet t'ju pagujë.

Zbritjet nga paga

Punëdhënësi juaj mund të bëjë vetëm disa zbritje të caktuara nga paga juaj dhe këto duhet të listohen në fletëpagesën tuaj. Në fletëpagesën që pranoni, duhet të paraqitet gjithmonë “shuma neto”, pasi të jenë bërë zbritjet.

Disa zbritje janë të detyrueshme me ligj, siç janë tatimet dhe kontributet për Sigurimin Kombëtar dhe të tjera zbritje për të cilat ju mund të keni rënë dakord në kontratën tuaj të punësimit, p.sh. tarifat për akomodimin ose transportin. Ju lutemi të vini re se disa zbritje të cilat përmenden në kontratë mund të mos jenë të ligjshme. Nëse nuk jeni i sigurt, verifikojeni këtë te GLAA-ja.

Edhe nëse keni rënë dakord për ndonjë zbritje, kjo nuk duhet ta çojë pagën tuaj më poshtë sesa niveli i pagës përkatëse minimale, me përjashtim të ndonjë shume të kufizuar për akomodimin. Kërkoni për **“pay and work rights”** [paga dhe të drejtat e punës] në faqen e internetit: **GOV.UK** për më shumë informacione.

Shëndeti dhe siguria në punë

Punëdhënësi juaj ka përgjegjësi ligjore për shëndetin dhe sigurinë tuaj në vendin e punës. Juve duhet t’ju jepen informata për shëndetin dhe sigurinë në punë, trajnim, veshje mbrojtëse dhe çdo zëvendësim të nevojshëm, aty ku e kërkon nevoja.

Pagesa e pushimit mjekësor

Në kontratën tuaj të punës duhet të deklarohet se çfarë pagese do të merrni nëse mungoni në vendin e punës për shkak të ndonjë sëmundjeje. Shuma minimale për të cilën ju keni të drejtë në Mbretërinë e Bashkuar është “SSP – Statutory Sick Pay” [Pagesa Ligjore e Pushimit Mjekësor]. Kjo aplikohet kur ju nuk jeni në punë për katër ose më shumë ditë rresht. Me anë të kontratës suaj, mund të merrni pagë shtesë apo përfitime në rrethana të tjera.

Termat dhe kushtet tuaja

Këto përbëjnë një marrëveshje midis jush dhe punëdhënësit tuaj. Në aspektin ligjor, nëse ju jeni punësuar për më shumë sesa një muaj, juve duhet t’ju jepen patjetër hollësitë me shkrim të termave dhe kushteve.

Ju duhet të merrni termat dhe kushtet e marrëdhënies së punës brenda dy muajsh nga data e fillimit të punës dhe në to duhet të bëjnë pjesë këto informata:

- Emri juaj
- Subjekti për të cilin punoni
- Lloji i punës që do të bëni
- Data e fillimit të punës
- Vendi juaj i punës
- Norma e pagës suaj dhe se sa shpesh do të paguheni (çdo javë apo çdo muaj)
- Orët e punës
- E drejta për pushime të paguara
- E drejta për pushim mjekësor të paguar
- Procedurat disiplinore, procedurat për shkarkimin nga puna dhe ato për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve
- Njoftimi që duhet të jepni nëse hiqni dorë, apo që duhet të merrni pas shkarkimit nga puna

Punëdhënësi juaj mund t'i ndryshojë termat dhe kushtet e kontratës suaj vetëm me lejen tuaj.

Na kontakti



Gangmasters & Labour Abuse Authority

PO Box 10272, Nottingham, NG2 9PB

www.gla.gov.uk

E-mail: intelligence@glaa.gsi.gov.uk



+44 (0)345 602 5020

Linja raportuese **konfidenciale falas:**



0800 432 0804

Për më shumë ndihmë vizitoni adresën: www.gla.gov.uk/contacts



Gangmasters &
Labour Abuse Authority



UNIVERSITY
of DERBY

Fletëpalosjet janë financuar nga

Akademia e GLAA-së

në partneritet me

Universitetin e Derbit



Rreth GLAA-së

Gangmasters & Labour Abuse Authority (GLAA) është një organizatë e cila është krijuar për të mbrojtur punëtorët nga shfrytëzimi.

Ne kemi punësuar hetues specialistë, të cilët janë në gjendje të shqyrtojnë problemet e punëtorëve, të cilat variojnë nga pagat më të ulëta nga ato që i takojnë punonjësit e deri te shkeljet që kanë të bëjnë me punën e detyruar, trafikimin e qenieve njerëzore, si dhe me aspekte të tjera të skllavërisë moderne.

GLAA-ja vazhdon të përdorë një skemë të fuqishme licencimi për “gangmasterat” – kompani dhe individë të cilët ofrojnë punëtorë për kryerjen e punëve në sektorin e prodhimeve të freskëta në Mbretërinë e Bashkuar. Këtu përfshihen bujqësia, kopshtaria, mbledhja e butakëve të detit dhe të gjitha përpunimet dhe paketimet e ndërlidhura.

Të gjithë “gangmasterat” e licencuar duhet të veprojnë në pajtueshmëri me një numër standardesh të rrepta të licencimit. Ofrimi pa licencë i punëtorëve të përkohshëm në industritë e përmendura më sipër përbën vepër penale për të cilën dënimi maksimal është 10 vite. Gjithashtu, vepër penale përbën edhe lidhja e marrëveshjeve me ofrues të palicencuar të fuqisë punëtore. Për këtë dënimi është jo më shumë sesa gjashtë muaj.

Ndihmoni në ndalimin e shfrytëzimit të punëtorëve

Kemi nevojë për ndihmën tuaj me qëllim që t'ju mbrojmë të drejtat dhe të sigurojmë që ju punoni në kushte për të cilat keni të drejtë sipas ligjit. Ju lutemi të na kontaktoni nëse mendoni se nuk jeni trajtuar në mënyrën e duhur, me drejtësi apo në mënyrë të ligjshme.

Nëse ju nuk ka informoni, ne nuk mund t'ju ndihmojmë

Ju mund:

- Të telefononi në numrin **0345 602 5020** (opsioni 2) për të folur me ne në mënyrë të drejtpërdrejtë - nga e hëna deri të premtën, nga ora 9 e mëngjesit deri në orën 5 pasdite (në dispozicion do të keni përkthyes)
- Të dërgoni e-mail në adresën: **intelligence@glaa.gsi.gov.uk**
- Të na telefononi FALAS në linjën tonë konfidenciale të raportimit, në numrin:
0800 432 0804
- Të na dërgoni informata përmes faqes sonë të internetit:
www.gla.gov.uk
- Të na shkruani në adresën: GLAA, PO Box 10272, Nottingham, NG2 9PB

Nëse dëshironi të diskutoni për të drejtat tuaja të punësimit me ndonjë këshilltar me përvojë, kontaktoni me Zyren vendore të "Citizens Advice Bureau" [Këshillimit të Qytetarëve] ose telefononi në linjën ndihmëse të "ACAS Helpline" [ACAS-it] në numrin:
0300 123 1100.

Standardet e Licencimit të GLAA-së

Punëdhënësit tuaj i kërkohet me ligjin e Mbretërisë së Bashkuar që t'i mbrojnë punëtorët nga trajtimi i keq dhe nga shfrytëzimi.

Të njëjtat ligje ju japin juve disa të drejta, të cilat kanë të bëjnë me gjëra të tilla si:

- Pagat tuaja – ju duhet të merrni Pagën Minimale Kombëtare
- Shuma e pagës për ditët e pushimit të paguar
- Termat dhe kushtet në kontratën tuaj
- Kohëzgjatja dhe shpeshtia e pushimeve të shkurtra gjatë orarit të punës
- Mënyra si trajtoheni në punë
- Mbrojtja e shëndetit, mirëqenies dhe sigurisë në punë, duke i kryer punët në atë mënyrë që ju të jeni të mbrojtur dhe/ose ofrimi i pajisjeve të sigurisë në punë, atëherë kur e kërkon nevoja
- Standardi i akomodimit dhe transportit nëse ofrohen nga punëdhënësi juaj

Standardet e Licencimit të GLAA-së – vazhdim

Të njëjtat të drejta mbrohen edhe me anë të standardeve të cilat zbatohen për licencën e GLAA-së.

Punëdhënësi juaj duhet të ketë një licencë aktuale, nëse ju çojnë të punoni në bujqësi, kopshtari, mbledhje të butakëve, si dhe në të gjitha përpunimet dhe paketimet e ndërlidhura.

Nëse keni dyshime se dikush punon pa licencë apo nuk plotëson kërkesat ligjore, ju lutemi të kontaktoni me GLAA-në.